VENDIM
Nr. 10, datë 7.2.2018

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN "MBI MINIMUMIN E REZERVËS SË DETYRUAR MBAJTUR NË BANKËN E SHQIPËRISË NGA BANKAT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 19 dhe nenit 43, shkronjat "a" dhe "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; si dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 29, datë 16.5.2012, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 4, shkronja "h" ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"Remunerimi i rezervës së detyruar" është shuma e interesit që paguhet nga Banka e Shqipërisë për bankat, për rezervën e detyruar të mbajtur nga këto të fundit në Bankën e Shqipërisë.

b) Në nenin 4, pas shkronjës "k" shtohet shkronja "l", sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"Ndërmjetës të tjerë financiarë e ndihmës financiarë" përfshin të gjitha institucionet e tjera që kryejnë ndërmjetësim financiar apo lehtësojnë ndërmjetësimin financiar (përjashtuar kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit), të tillë si: institucionet e kreditit, institucionet që ofrojnë qiranë financiare (*leasing*), institucionet e financimit të transaksioneve tregtare, institucionet e mikrokredisë, *faktoringut*, të gjitha shërbimet e pagesave dhe transferimit të parave, unionet e shoqërive të kursim-kreditit, shoqëritë administruese të fondeve të investimit dhe të fondeve të pensionit vullnetar, zyrat e këmbimit valutor etj.

c) Në nenin 6, pika 1 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"Baza e rezervës përfshin detyrimet nga pranimi i fondeve nga bankat, në formë depozitash dhe instrumentesh borxhi të emetuara prej vetë bankave, të pasqyruara në bilancin kontabël të tyre, në lekë dhe në valutë. Këto detyrime, ndër të tjera, përfshijnë:

a) detyrimet ndaj shoqërive të kursim-kreditit;

b) detyrimet ndaj fondeve të investimit;

c) detyrimet ndaj fondeve të pensionit vullnetar;

d) detyrimet ndaj shoqërive të sigurimit;

e) detyrimet ndaj ndërmjetësve të tjerë financiarë e ndihmësve financiarë.".

d) Në nenin 7, në pikën 1, pas shkronjës "c" shtohet shkronja "d", sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"d) instrumentet e borxhit të emetuara nga banka me afat maturimi fillestar mbi 2 vjet.".

e) Në nenin 9, pika 3 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"Bankat dorëzojnë në Bankën e Shqipërisë pasqyrën(at) e llogaritjes së rezervës së detyruar në lekë dhe në valutë sipas anekseve nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur kësaj rregulloreje, brenda datës 10 të muajit në të cilin fillon periudha e mbajtjes së rezervës së detyruar.".

f) Në nenin 10, pika 1 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"Bankat mbajnë rezervën e detyruar në llogaritë e tyre rezervë në lekë dhe në valutë (në euro dhe në dollarë amerikanë) në Bankën e Shqipërisë, sipas përcaktimit në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.".

g) Në nenin 12/1, pika 2 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"Teprica e llogarisë rezervë në euro është diferenca e gjendjes në llogarinë rezervë me rezervën e detyruar të mbajtur në euro, e llogaritur çdo ditë.".

h) Në nenin 12/1, pika 2/a ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"Teprica e llogarisë rezervë në dollarë amerikanë është diferenca e gjendjes në llogarinë rezervë me rezervën e detyruar të mbajtur në dollarë amerikanë, e llogaritur çdo ditë, por jo më e vogël se niveli minimal

i tepricës.”.

i) Në nenin 15, pika 1 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Departamenti i Operacioneve Monetare verifikon saktësinë e raportimit të rezervës së detyruar në përputhje me të dhënat e raportuara në SRU nëpërmjet sistemit ERRS dhe/ose nëpërmjet inspektimeve në vend të bankës, të kryera nga Departamenti i Mbikëqyrjes.”.

j) Në nenin 15, pika 2, shkronja “b” shfuqizohet.

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare dhe Departamenti i Mbikëqyrjes.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë, dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin në Buletinin Zyrtar.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet neni 1, shkronja “b” e vendimit të Këshillit Mbikëqyrës 38, datë 25.6.2014, “Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat””.

Ky vendim hyn në fuqi më 24 shkurt 2018.

KRYETARI
Gent Sejko